

“Mbështetje rajonale për arsimin gjithëpërfshirës”



Paraqitja e programeve ekzistuese cilësore të trajnimit për arsimin gjithëpërfshirës në Rajonin e Evropës Juglindore

Raport përmbledhës

Opinionet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyrojnë domodoshmërisht politikën zyrtare të Këshillit të Evropës.

Realizuar në partneritet me



THE UNIVERSITY of EDINBURGH

PH Zürich

Përmbajtja

| | |
|---|----|
| 1. Arsimi përfshirës dhe zhvillimi profesional i mësuesve | 3 |
| 2. Ndërtimi i studimit mbi paraqitjen e “Programeve të Trajnimit dhe Arsimit Gjithëpërfshirës ” | 5 |
| 3. Rezultatet e ushtrimit të paraqitjes dhe të workshopeve | 7 |
| 4. Diskutimi dhe rruga për të ecur përpara | 11 |
| 5. Referenca | 14 |

Ekipi i ekspertëve: Judith Hollenweger, Nataša Pantić, Lani Florian
Vizitat në terren nga: Judith Hollenweger, Nataša Pantić
Raporti: Judith Hollenweger

Shtator 2014

1. Arsimi gjithëpërfshirës dhe zhvillimi profesional i mësuesve

Përse bën fjalë Projekti i Përbashkët

Shkollë gjithëpërfshirëse është ajo shkollë ku çdo fëmijë është i mirëpritur, çdo prind i përfshirë dhe çdo mësues i vlerësuar. Kjo është premisa dhe premtimi kryesor i projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Mbështetje rajonale për arsimin gjithëpërfshirës në Evropën Juglindore”. Projekti ka pesë komponentë kryesorë për të mbështetur arritjen e këtij vizioni: (1) të mësuarit e ndërsjellë midis shkollave gjithëpërfshirëse pilot; (2) ndërgjegjësimin përmes organizimit të aktiviteteve lokale për palët përkatëse të interesuara; (3) lehtësimin e dialogut për politikave dhe të mësuarit për çështjet e politikave, (4) hartimin e moduleve dhe programeve për zhvillimin profesional të mësuesve, dhe (5) krijimin e partneriteteve me aktorë rajonalë për të ndihmuar heqjen e barrierave për grupet e pafavorizuara¹. Projekti i Përbashkët kontribuon në drejtim të zbatimit të praktikave gjithëpërfshirëse dhe ndërtimin e partneriteteve midis shkollave. Për të zhvilluar shkolla gjithëpërfshirëse, mësuesit duhet të transformojnë praktikën mësimdhënëse, duke kaluar nga përcjellja e programit kurrikular drejt mbështetjes së proceseve të të nxënësve, larg nga izolimi nëpër klasa drejt bashkëpunimit me profesionistë të tjerë dhe me familjet. Si rrjedhojë, bashkëpunimi në rrjete dhe partneritetet janë thelbësore për projektin, i cili ka ngritur tre rrjete për të promovuar këtë vizion, Rrjeti i Mësuesve [TeacherNet], Rrjeti i Politikave [PolicyNet] dhe Rrjeti i Shkollave [SchoolNet]. Këta rrjete po krijojnë komunitete të nxënësve që i nxjerrin shkollat dhe mësuesit nga izolimi i tyre.

Çfarë është përfshirja dhe cilat shkolla janë përfshirëse?

Shkollat gjithëpërfshirëse janë themeli i shoqërive gjithëpërfshirëse dhe të drejta. Arsimi gjithëpërfshirës ka të bëjë me të gjithë nxënësit në komunitete të ndryshme të nxënësve, dhe jo vetëm me disa që shihen si të ndryshëm për një arsye apo tjetër (Pantić e të tjerë, 2010). Ndryshimet e lidhura me rrethanat sociale, gjuhën, aftësinë dhe kulturën e mësuesve, si edhe me nxënësit dhe familjet e tyre shihen si asete për të nxënësin në vend që të shihen si ndërlikime për punën e mësuesve. Qasja me bazë të drejtën për arsimim siguron që fëmijët të perceptohen si bartës të të drejtave dhe prindërit e tyre si rojtarë ose mbështetës të këtyre të drejtave. Gjithëpërfshirja në arsim është një proces që synon t’i kapërcejë pengesat ndaj të nxënësve dhe pjesëmarrjes dhe t’i përgjigjet diversitetit (Agjencia Evropiane, 2013). Shkollë gjithëpërfshirëse është ajo shkollë ku të gjithë janë të rëndësishëm dhe ku gjërat zgjidhen së bashku dhe jo me një ndarje të ngurtë të përgjegjësisë dhe punës. Shkollat gjithëpërfshirëse e perceptojnë të nxënësin dhe krijimin e njohurive si veprimtarinë bazë të tyre, jo vetëm për nxënësit, por edhe për mësuesit dhe prindërit. Shkollat gjithëpërfshirëse janë organizata të nxënësve, që përdorin aktivisht bashkëpunimin dhe punën e përbashkët për të zhvilluar praktikën mësimore.

Cilat janë veçoritë e mësuesve gjithëpërfshirës?

Agjencia Evropiane (2012) ka përgatitur një profil të të mësuesit gjithëpërfshirës me katër fusha kompetencash: (1) Vlerësimi i diversitetit të nxënësve, (2) Mbështetja e të gjithë nxënësve, (3) Puna me të tjerët, dhe (4) Zhvillimi personal profesional. Si rrjedhojë, mësuesit duhet të zgjerojnë perceptimin që kanë për nxënësit e tyre; ata janë jo vetëm nxënës që kanë nevojë t’i mësojnë, por edhe persona të drejtat e të cilëve duhen respektuar. Mësuesit duhet të zhvillojnë mënyra të reja bashkëpunimi me të tjerët dhe ta ndajnë pushtetin e tyre në lidhje me atë që ndodh në klasa. Mësuesit gjithëpërfshirës përdorin një qasje të nxënësve që vënë qendër fëmijën, ku çdo fëmijë vlerësohet dhe trajtohet si një person dhe nuk etiketohet si një rast. Ata e kuptojnë diversitetin e fëmijëve dhe nuk i përdorin veçoritë e nxënësve për t’i kategorizuar apo

¹ Shih faqen e internetit të Projektit: <http://pjp-eu.coe.int/web/inclusive-education>

etiketuar me qëllim që të përlligjin trajtimin e ndryshëm të tyre. Për t'u bërë një mësues gjithëpërfshirës, kërkohet të transformohet identiteti dhe premiset bazë në themel të praktikave të përdorura. Mësuesit gjithëpërfshirës e pranojnë ndikimin e thellë që besimet dhe qëndrimet e tyre kanë te nxënësit, por edhe te ndjenjat që ata vetë kanë për efikasitetin e tyre.

Përse janë mësuesit kaq të rëndësishëm?

Mësuesit janë agjentë kyç të ndryshimit në procesin e krijimit të shkollave – gjithëpërfshirëse. Për shkak se ata e kalojnë pjesën më të madhe të kohës me nxënësit e tyre në klasa, ata kanë një ndikim të thellë në identitetin dhe të nxënësve të tyre. Mësuesit shpesh përballen me qëllime kundërthënëse, të cilat duhet t'i arrijnë, për shembull, duhet të sigurojnë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve dhe në të njëjtën kohë të dalin mirë në vlerësimet e shkollës. Mësuesit mund të donin të shpenzonin më shumë kohë me nxënës të veçantë, por në të njëjtën kohë, ata duan të jenë të drejtë me të gjithë nxënësit. Arsimit gjithëpërfshirës ka të bëjë me të kuptuarit e aspekteve komplekse të të qenit mësues dhe me të punuarit me to për të mirën e të gjithëve. Për të punuar aktivisht dhe në mënyrë konstruktive me qëllime të tilla kundërthënëse, mësuesit duhet të jenë profesionistë reflektues të cilët kërkojnë bashkëpunim me të tjerët për të zhvilluar profesionin e tyre. Profesionistët reflektues angazhohen në dialog me nxënësit, prindërit dhe kolegët për të krijuar një ide më të mirë të situatave komplekse; ata e kuptojnë veten jo vetëm si mësues por edhe si nxënës. Për të arritur ndryshimet e nevojshme, mësuesit dhe profesionistët e tjerë duhet të zhvillojnë të kuptuarit e tyre të të nxënësve si krijim njohurish dhe jo si riprodhim njohurish. Të nxënësve si nxënës, ashtu edhe të nxënësve si profesionist është një proces aktiv i zgjidhjes së problemeve, i angazhimit për t'u dalë gjërave përpara dhe në reflektim, në komunikim dhe në veprim.

Cili është objektivi i Rrjetit të Mësuesve?

Rrjeti i Mësuesve kërkon të kontribuojë në drejtim të krijimit të shkollave më gjithëpërfshirëse, duke u fokusuar te zhvillimi profesional. Gatishmëria e mësuesve për të nxënë gjatë gjithë jetës është parakusht për zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës, por kështu është edhe mundësia për të pasur shanse shumë cilësore për t'u angazhuar në zhvillimin profesional. Me anë të edukimit fillestar të mësuesve dhe zhvillimit të vazhdueshëm profesional, trajnimit apombështetjes nga mentorët , mësuesit mund të zhvillojnë praktikën e tyre për t'u bërë më gjithëpërfshirës. Të kuptuarit më të mirë të aftësive që nevojiten nga mësuesit për të zbatuar arsimin gjithëpërfshirës është si rrjedhojë i rëndësishëm për të zhvilluar ose përditësuar modulet dhe programet ekzistuese të edukimit dhe trajnimit të mësuesve. Duke qenë mundësi të formalizuara të nxënësve, ato kanë një ndikim të rëndësishëm në zhvillimin profesional të mësuesve. Një nga detyrat e Rrjetit të Mësuesve është të zhvillojë vizionin e një mësuesi gjithëpërfshirës dhe të angazhohet në diskutime rreth përmirësimit të praktikave aktuale të lidhura me edukimin e mësuesve. Të pasurit e një vështrimi të përgjithshëm të praktikave të sotme në edukimin dhe trajnimin e mësuesve në rajon është parakusht për një diskutim të informuar.

Çfarë është bërë ndërkohë në rajon?

Para disa vjetësh Bashkimi Evropian krijoi "Platformën e Ballkanit Perëndimor për Arsimin dhe Trajnimin" për të bashkëpunuar me Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kroacinë, Malin e Zi, Serbinë "Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë" dhe Kosovën² në fushën e arsimit. Edukimi i mësuesve u identifikua si një përparësi e lartë e Ministrive të Arsimit. Si pasojë, BE-ja porositi një studim për të pasqyruar situatën i cili doli me shtatë raporte për vendet për "Edukimin dhe Trajnimin e Mësuesve" dhe një raport përmbledhës për rajonin (EC 2013a). BE-ja ka botuar gjithashtu një raport për "Mbështetjen e zhvillimit të

² Ky përcaktim nuk cenon qëndrimet ndaj statusit dhe është në p përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Këmbeve të Bashkuara dhe opinionin e GjED-së për Deklarimin e Pavarësisë së Kosovës

aftësive të mësuesve për të pasur rezultate më të mira të të mësuarit” në vitin 2013 (EC 2013b), që ka lidhje për qëllimin e këtij raporti.

Në 2009, Fondacioni Evropian i Trajnimit (ETF) porositi një studim të titulluar “Pasqyrimi i politikave dhe praktikave për përgatitjen e mësuesve të arsimit përfshirës në kontekstet e diversitetit social dhe kulturor”. Rezultatet e këtij aktiviteti të gjerë pasqyruar jepen në raportet e shtatë vendeve dhe në një raport përmbledhës (Pantić e të tjerë, 2010), i cili paraqet një listë me çështje që duhen adresuar si edhe sugjerime për rrugët që duhen ndjekur në të ardhmen.

Për çfarë bën fjalë ky raport?

Ky raport jep një përmbledhje të studimit paraqitës dhe diskutimeve dhe shkëmbimeve të mëpasshme të mendimeve të Rrjetit të Mësuesve. Ai dëshiron të kontribuojë në diskutime, në krijimin e vizionit dhe në procesin e zhvillimit të Rrjetit të Mësuesve dhe rrjeteve të tjera të Projektit të Përbashkët të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Një paraqitje paraprake e aktiviteteve në fushën e edukimit të mësuesve për arsimin përfshirës shërbeu si pikënisje për diskutimet gjatë workshopeve të Rrjetit të Mësuesve. Pjesëmarrësit e workshopeve të Rrjetit të Mësuesve konfirmuan rezultatet paraprake dhe i përdorën ato për rrahje të mëtejshme mendimesh në lidhje me zhvillimin profesional të mësuesve dhe për të përditësuar edukimin dhe praktikën aktuale të trajnimit të mësuesve. Metodologjia e zgjedhur për këtë punë u përpoq të lehtësonte integrimin e informacioneve të shumëllojta dhe të nxiste komunikimin. Ajo u zgjodh për të mbështetur proceset e krijimit të njohurive të përbashkëta, bazuar në premisën se njohuritë e rëndësishme shpërndahen gjithnjë, duke parashikuar kështu ndryshime dhe shtesa në paraqitjen e gjetjeve paraprake. Rezultatet e procesit të paraqitjes janë kuptuar si pikënisje për diskutime të mëtejshme dhe jo si deklarata përfundimtare apo konkluzione për situatën e edukimit të mësuesve për gjithëpërfshirje.

2. Skica konceptuale e studimit për paraqitjen e “Programeve të trajnimit për arsimin gjithëpërfshirës”

Cilat ishin synimet dhe detyrat e studimit?

Objektivi i këtij studimi ishte të kontribuonte në punën e Rrjetit të Mësuesve, përmes ofrimit të informacionit bazë për modulet dhe programet ekzistuese që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës. Përveç kësaj, rezultatet duhet të informonin gjithashtu përditësimin e aktiviteteve aktuale të edukimit dhe trajnimit të mësuesve. Prandaj, qëllimi ishte të paraqiste programet ekzistuese të edukimit dhe trajnimit cilësor gjithëpërfshirës në rajon, të ofronte një bazë empirike për diskutimet e Rrjetit të Mësuesve dhe të kontribuonte në drejtim të përditësimit të moduleve dhe programeve novatore që duhen përdorur dhe zbatuar në mbarë rajonin. Studimi nuk kërkoi të përfshinte të gjitha aktivitetet ekzistuese të edukimit dhe trajnimit të mësuesve në rajon, por të krijonte një kampion që të ishte përfaqësues i diversitetit të praktikës në përgjithësi. Kjo shërbeu për të krijuar një bazë të rëndësishme njohurish, e cila mund të zgjerohet më vonë, por që të ishte e përshtatshme për të lehtësuar diskutimin fillestar të Rrjetit të Mësuesve. Si rrjedhojë, detyrat kryesore të studimit përfshinin identifikimin e moduleve të edukimit dhe trajnimit, mbledhjen e të dhënave të duhura për procesin e paraqitjes dhe organizimin e këtyre të dhënave në një mënyrë që të lehtësonte përditësimin dhe zbatimin në të ardhmen në gjithë rajonin. Ushtrimi përfshiu aktivitete të lidhura me edukimin fillestar dhe para shërbimit të mësuesve, deri në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve të cilët ushtrojnë profesionin dhe në trajnimin për përgatitjen e mësuesve si mentorë apo këshillues. Workshopeve e mbajtura në Shkup (24-25 qershor) dhe Tiranë (2-3 korrik) u përdorën për të konfirmuar rezultatet e studimit, për të krijuar vizione të përbashkëta dhe

prodhuar informacion që mund të përdorej më vonë për të udhëhequr procesin e përditësimit të moduleve dhe të programeve ekzistuese.

Si u krye studimi paraqitës?

Informacioni i përdorur për studimin u mbledh gjatë vizitave në terren ku u mbajtën biseda me ofruesit e programeve dhe moduleve në mbarë rajonin. Vizitat në terren u organizuan nga punonjësit e projektit dhe mbuluan të gjithë vendet përfituese. U desh të përgatitej një kuadër i përbashkët i cili mund të përdorej për t'i bërë programet dhe modulet e ndryshme të krahasueshme. Për këtë qëllim, për të bashkuar informacionet përkatëse u përdor modeli i sistemit të aktiviteteve (Engeström 1987, 2001, 2008) . Ky model lejon paraqitjen konsistente të aktiviteteve që përfshijnë një mori organesh trajnuese, qasjesh, kontekstesh sociale dhe qëllimesh, pa larguar vëmendjen nga ndërveprimet komplekse dhe praktikrat specifike që u përfshinë në aktivitetet e edukimit të mësuesve. Modeli u thjeshtua disi për të përmbushur kërkesat e këtij studimi. Ai bashkon informacionin për ofruesin e programit (subjekti), grupet e synuara nga trajnimi (objekti), kontekstin social në të cilin zhvillohet programi, si edhe instrumentet, konceptet, artefaktet apo metodat e përdorura për të arritur rezultatet e synuara:




Figura 1: Modeli i përgjithshëm i sistemeve të aktiviteteve (i thjeshtuar)

Pyetjet e mëposhtme trajtojnë komponentët e ndryshëm të sistemit të aktiviteteve dhe u përdorën për të analizuar aktivitete të ndryshme të edukimit të mësuesve për arsimin gjithëpërfshirës (shih Figurën 1):

- Subjekti i aktivitetit: Kush i realizon apo ofron modulet? Identifikoni individin, agjencinë, grupin apo organizatën që ofron programin.
- Rezultati i aktivitetit: Cilat janë rezultatet e pritshme? Identifikoni qëllimet që kërkon të arrijë.
- Objekti i aktivitetit: Kush apo çfarë synohet? Identifikoni grupin e synuar, kompetencën apo problemet që moduli synon dhe dëshiron të ndryshojë.
- Instrumentet dhe artefaktet e përdorura në aktivitet: Si realizohet moduli? Identifikoni instrumentet, metodat, konceptet, dhe teoritë e përdorura për të arritur rezultatet e pritshme.
- Konteksti social në të cilin ndodh aktiviteti: në cilin kontekst ofrohet moduli? Identifikoni kontekstin social, grupet, apo organizatat që preken nga aktiviteti i edukimit të mësuesve.

Komponentët e sistemit të aktiviteteve u përdorën për të zhvilluar pyetje të caktuara gjatë vizitave në terren dhe më pas për të paraqitur programin në formë grafike. Informacioni u transformua në një grafik për të dhënë një përmbledhje të karakteristikave kryesore të secilit program apo modul. Ky informacion u përdor për një analizë të përgjithshme si edhe për një analizë të fokusuar në edukimin fillestar të mësuesve, zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e mësuesve në arsimin gjithëpërfshirës.

Cilat aktivitete u analizuan dhe si u përdorën analizat?

U përzgjedhën aktivitete shumë të ndryshme që lidheshin me zhvillimin profesional të mësuesve; disa harta përfaqësojnë aktivitete shumë të gjera (p.sh., programe të trajnimit fillestar të mësuesve) disa të tjera programe më të shkurtra, të fokusuara (p.sh., modul individual tre ditor). Në disa raste, programet e

përgjithshme të përshkruara gjatë vizitave në terren synonin të arrinin qëllime më të gjera (p.sh., të zhvillonin praktikën në shkollë apo komunitete) dhe të përfshinin aktivitete për trajnimin e mësuesve si një qasje për arritjen e këtyre qëllimeve të përgjithshme. Në raste të tilla, aktiviteti i trajnimit të mësuesve u zgjodh si aktiviteti kryesor për t'u paraqitur, ndërsa projekti i përgjithshëm u përfshi si pjesë e kontekstit social në të cilin ndodh trajnimi.

Hartëzimet e secilit aktivitet për trajnimin e mësuesve u përdorën për të krijuar një ide të përgjithshme të praktikave aktuale në lidhje me të gjithë komponentët e modelit të aktivitetit. Karakteristikat e secilit komponent të aktivitetit u përmbledhën në listë për të përshkruar praktikën aktuale. Këto lista u përdorën për të bërë paraqitje përmbledhëse për edukimin fillestar, zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe programet e trajnimit për mentorim. Këto përshkrime lehtësuan procesin e konfirmimit dhe diskutimit gjatë workshopeve të Rrjetit të Mësuesve në Shkup dhe Tiranë. Metodologjia e workshopeve u bazua në metodologjinë e studimit paraqitës (shih Figurën 2), duke iu referuar komponentëve kyç të modelit të aktivitetit. Rezultatet e workshopeve u përfshinë në raportin përfundimtar dhe do të udhëhoqin punën në të ardhmen. Aktivitete të përzgjedhura më pas mund t'i nënshtrohen një analize të thelluar, për shembull, për të kuptuar më mirë efektivitetin e tyre, por edhe për të identifikuar tensionet dhe kontradiktat.




Figura 2: Sistemi i aktivitetit që udhëhoqi metodologjinë e workshopeve

3. Rezultatet e studimit paraqitës dhe të workshopeve

Cilat programe u paraqiten?

Programet dhe modulet e mëposhtme u paraqitën dhe pastaj u përdorën për diskutime gjatë workshopeve: Shqipëria: Një program masteri profesional i ofruar nga një universitet, dy programe të ofruara nga OJQ-të. Bosnja dhe Hercegovina: Pesë programe të ofruara nga OJQ-të, një nga drejtorët e shkollave dhe nga pedagogët, një nga një lektor për një universitet. Kroacia: një program i ofruar nga një universitet, katër programe të ofruara nga OJQ, një nga një ekip i lëvizshëm këshilluesish. Mali i Zi: një program i ofruar nga një universitet bashkë me UNICEF-in, një program në përgatitje e sipër nga dy universitete, gjashtë programe nga OJQ-të, tre programe të ofruara nga Ministria e Arsimit apo Instituti i Arsimit. "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë": Një program për edukimin fillestar të mësuesve, i ofruar nga një universitet, katër programe të ofruara nga OJQ. Serbia: Tre programe të ofruara në universitete (ndonjëherë iniciativa

të një individi), dy programe të ofruara nga OJQ-të, një program i ofruar nga Instituti i Arsimit. Kosova*: Një program për zhvillimin profesional në një universitet, tre programe të ofruara nga OJQ.

Programet dhe modulet e përshkruara u ofruan nga individë, OJQ të vogla lokale, organe të qeverisjes, universitete dhe Organizata Qeveritare (OQ) ndërkombëtare dhe OJQ. Formatet përfshinin workshope dyditore, deri në programe të plota studimore në universitete. Metoda dhe qasje të ndryshme u përdorën për grupe të ndryshme të synuara. Disa programe u fokusuan te mësues të veçantë, të tjerë te komunitetet e shkollave apo te partnerët përkatës në nivele lokale apo rajonale. Ato u realizuan në kontekste të ndryshme sociale, që nga veprime në dukje të izoluar të individëve, deri te aktivitetet e mbështetura nga komunitetet lokale dhe aktivitete të miratuara nga qeveritë, apo aktivitete që zbatojnë legjislacione të reja. Gjithashtu ato u fokusuan në rezultate të ndryshme të pritshme, që nga thjesht transferimi i informacionit deri te ndërtimi i kapaciteteve në shkolla, apo nga realizimi i ndryshimeve sociale në komunitete.

Gjatë workshopeve u përmenden disa programe shtesë dhe disa ishin shumë mirë të dokumentuara për t'u përfshirë në ushtrimin e paraqitjes. Bazuar në rezultatet e studimit, pjesëmarrësit krijuan vizionin e tyre të një mësuesi përfshirës dhe diskutuan mjetet që mund ta ndihmonin procesin e ndërtimit të kapaciteteve.

Cilat janë dallimet midis tre fazave të zhvillimit profesional?

Tre fazat e zhvillimit profesional ndryshojnë përsa i takon ofruesve, rezultateve të pritshme dhe synimeve (p.sh., mësues nxënës, mësues, mësues ekspertë). Edukimi fillestar i mësuesve bëhet nga universitetet, përqendrohet kryesisht në krijimin e identitetit të mësuesit gjithëpërfshirëspërfshirës, dhe synon të trajnuarin si nxënës; mësuesit nxënës bëhen mësues të rinj.




Figura 3: Aktivitetete “Edukimit para shërbimit ose fillestar të mësuesve”

Zhvillimi i vazhdueshëm profesional fokusohet në krijimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Përveç krijimit të kompetencave për arsimin gjithëpërfshirës, konteksti specifik në të cilin mësuesit punojnë duhet gjithashtu të merret parasysh: i trajnuari shihet si nxënës dhe si profesionist: mësuesit e rinj bëhen mësues me përvojë.

«Zhvillimi i vazhdueshëm profesional»




Figura 4: Aktivitete për “Zhvillimin e vazhdueshëm profesional”

Trajnimi i mësuesve mentorë fokusohet jo vetëm në identitetin e mësuesve dhe kompetencat e tyre për arsimin gjithëpërfshirës, po edhe në transferimin sistematik të njohurive dhe të nxënësve të përbashkët. Ai ndihmon për të lidhur praktikën e ndryshme dhe i vë theksin njohurive si një mjet për të trajnuar të tjerët. I trajnuari shihet si një nxënës, si profesionist dhe si bartës i njohurive për të tjerët, i aftë të mbështesë të nxënësit dhe praktikën e tyre: mësuesit me përvojë bëhen mësues ekspertë.

«Këshillimi, trajnimi dhe stërvitja e edukatorëve dhe trajnuesve»




Figura 5: Aktivitete të “Trajnimit dhe këshillimit të mësuesve edukatorë dhe trajnerëve për t'u bërë mentorë”

Formalizimi ose institucionalizimi i këtyre praktikave ndryshon nga një program në tjetrin dhe nga një vend në tjetrin në rajon. Për disa përfitues, arsimit gjithëpërfshirës është një pjesë e institucionalizuar e edukimit fillestar të mësuesve, për të tjerë nuk është. Në mbarë rajonin, bëhen përpjekje për të formalizuar edukimin e vazhdueshëm të mësuesve ose përmes akreditimit, ose me anë të ngritjes së qendrave për zhvillimin e vazhdueshëm profesional në universitete apo agjenci të qeverisë. Praktika më pak e formalizuar dhe si pasojë më pak e institucionalizuar është ajo e programeve të stërvitjes apo këshillimit të mësuesve. Paraqitja e këtyre tre llojeve të aktivitetëve për edukimin e mësuesve është vetëm paraprake dhe kryesisht ka

shërbyer për të lehtësuar diskutimet në workshope. Ajo mund të përdoret gjithashtu për të drejtuar zhvillimin apo përditësimin e moduleve dhe programeve përkatëse.

Cilat ishin rezultatet e workshopeve?

Workshopet në Shkup dhe Tiranë krijuan mundësi për konfirmimin e rezultateve të paraqitjes nga pjesëmarrësit e Rrjetit të Mësuesve. Diskutimet konfirmuan gjetjet e përgjithshme si edhe konkluzionet paraprake dhe shtuan informacion të vyer për plotësimin e studimit. U përmenden një numër i vogël aktiviteteve shtesë të edukimit të mësuesve dhe si pasojë u shtuan në studim. Pjesëmarrësit bënë gjithashtu komente të përgjithshme për për edukimin e mësuesve, për të nxitur dhe mbështetur arsimin gjithëpërfshirës, për shembull, ngritja e ndërgjegjësimit u perceptua si thelbësore për ndryshimin e qëndrimeve. Pjesëmarrësit po ashtu shprehën nevojën për një bashkëpunim më të ngushtë midis shkollave, universiteteve dhe politikëbërësve për të siguruar vijimin e praktikave të mira në të gjitha fazat e edukimit të mësuesve. Kjo përputhet me mbushjen e hendekut midis teorisë, praktikës dhe politikës, që shihet si një nga barrierat kryesore. Një çështje tjetër e përgjithshme ishte edukimi i mësuesve të lëndëve dhe të mësuesve të arsimit dhe formimit profesional (AFP). Të dy kategoritë e mësuesve, por në veçanti, mësuesit e AFP-së, perceptohen se nuk janë të përgatitur aq sa duhet për arsimin gjithëpërfshirës apo se nuk marrin trajnim të mjaftueshëm për pedagogjinë gjithëpërfshirëse.

Për sa i takon edukimit fillestar apo para fillimit të punës të mësuesve, pjesëmarrësit vunë në dukje se trajnimi në universitet duhet të jetë i lidhur më mirë me shkollat. Kjo gjë mund të ndihmojë gjithashtu për të mbushur hendekun e mungesës së lidhjes midis zhvillimit fillestar dhe të vazhdueshëm profesional të mësuesve, që është i pranishëm në gjithë rajonin. Mësuesit mentorë u konsideruan si një grup i rëndësishëm për t'u synuar, dhe u përcaktua nevoja për rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive më të mira të lidhura me arsimin përfshirës. Pjesëmarrësit ishin të mendimit se të gjithë mësimdhënësit e universitetit duhet të dinë gjërat bazë të arsimit gjithëpërfshirës. Ata vunë në dukje gjithashtu se shumë fakultete pedagogjike dhe universitete nuk kanë as modulet bazë për arsimin gjithëpërfshirës, gjë që u konsiderua si e rëndësishme për të përgatitur më mirë studentët mësues për arsimin gjithëpërfshirës. Së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, u sugjerua se procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për edukimin fillestar të mësuesve duhet të jetë më i rreptë.

Aktiviteteve në lidhje me zhvillimin e vazhdueshëm profesional u panë nga pjesëmarrësit se pasqyronin një praktikë të shumëllojtë dhe të pasur e cila u jep mësuesve informacion dhe njohuri të duhura. Ata shprehën nevojën për mjedise më komunikuese, ku mësuesit mund të shkëmbejnë praktikën më të mira dhe të mësonin nga njëri-tjetri. U përmendën programe shtesë që mund të ishin të dobishme për të zhvilluar praktika gjithëpërfshirëse të tilla si: të nxënësit nga shokët, krijimi i ekipeve të lëvizshme gjithëpërfshirëse, programe shumë kulturore dhe programe që mbështetin mësuesit në përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. U përmend gjithashtu edhe trajnimi në gjuhën e shenjave si diçka që mungon. Çështjet e edukimit të Romëve u menduan si çështje tejet të rëndësishme për arsimin gjithëpërfshirës në të ardhmen.

Për sa u takon programeve për përgatitjen e mentorëve, u ngrit çështja nëse në rajon kishte programe shtetërore për këtë. Ideja për këto programe mbeti e paqartë gjatë diskutimit dhe pati nevojë për sqarime se ç'do të thotë. Mbeti e paqartë nëse të nxënësit nga bashkëmoshatarët mund të konsiderohej si mentorim. Për shembull, përdorimi i metodës së "orës së hapur", kur kolegët japin mendime të strukturuar mund të konsiderohet thjesht si të nxënësit nga shokët, apo mentorim? A mund të konsiderohen programet e trajnimit të trajnuesve si "trajnim i trajnerëve" apo janë thjesht pjesë e zhvillimit të vazhdueshëm profesional? A duhen konsideruar si të tilla edhe aktiviteteve që synojnë trajnimin e mësuesve mentorë? A duhet parë "mentorimi" si një aktivitet i veçantë apo është ai thjesht një aspekt i edukimit të mësuesve, për shembull, si mentorimi i studentëve gjatë praktikës, apo mbështetja e mësuesve

të rinj gjatë fazës së orientimit? Mentorimi ka të bëjë kryesisht me transferimin e teorisë në praktikë, apo me zbatimin?

Çfarë vizionesh u zhvilluan nga pjesëmarrësit?

Mësuesi gjithëpërfshirës shihet si një anëtar i ekipit që nuk punon më për vete. Ai ose ajo jo vetëm që punon me kolegë, por edhe me familjet dhe me komunitetin; pjesëmarrësit e përmendur në “Trekëndëshin e artë” të Familjes, Shkollës dhe Komunitetit. Pra, mësues gjithëpërfshirës janë të gjithë aktorët që kontribuojnë ose pengojnë procesin e gjithëpërfshirjes në të gjitha nivelet e shoqërisë dhe të komunitetit. Ata janë profesionistë që mendojnë, që kanë një pikëpamje pozitive për jetën dhe që besojnë se çdo nxënës mund të mësojë. Ata dëgjojnë zërat e nxënësve dhe kanë njohuri të mira për psikologjinë e fëmijës. Mësuesit ndërtojnë kapacitetet e tyre duke zbatuar njohuritë në situata konkrete të nxëni dhe gjatë trajnimit praktik. Të nxënëtit nga shokët shihet si një metodë e rëndësishme e rritjes së kapaciteteve, për shembull, përmes të punuarit me ekipe të lëvizshme, të cilët mund të ndihmojnë në procesin e zbatimit në shkollë. Pjesëmarrësit theksuan faktin se të nxënëtit për gjithëpërfshirjen jo gjithnjë duhet të fokusohet tek arsimit gjithëpërfshirës, por mund të arrihet edhe në mënyra të tërthorta, me anë të teatrit, muzikës apo aktiviteteve komunitare. Gjithashtu, u ndërtuan vizione në lidhje me aktivitetet e ardhshme në shkollë, për të nxitur arsimin gjithëpërfshirës. Ato nuk shihen si module apo programe për edukimin e mësuesve, por si aktivitete që kontribuojnë në rritjen e kapaciteteve për arsimin gjithëpërfshirës. Pjesëmarrësit folën për projekte në bazë shkolle, të cilat ndihmojnë për të zhvilluar disa aspekte që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës, për shembull, një program shkëmbimi midis një shkolle në Novi Sad me homologen e saj në Hungari. Dhënia e mbështetjes mësuesve për të përmirësuar praktikën e personalizimit të mësimdhënies, menaxhimi i diversitetit dhe monitorimi i progresit të nxënësve u panë si komponentë të rëndësishëm për të përmirësuar arsimin gjithëpërfshirës. Gjithashtu duhet dhënë ndihmë për të lehtësuar paqësimin dhe ndërmjetësimin për të siguruar drejtësi sociale dhe për të promovuar diversitetin. Mjetet, qasjet apo metodat ndërvepruese që lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e përvojave u panë si shumë të rëndësishme për të arritur arsimin përfshirës. Mësuesit duhen mbështetur me materiale dhe mjete didaktike që gjenden në shkollat lokale, por gjithashtu duhet të mbështeten që t’u përshtaten klasave gjithëpërfshirëse edhe nuk ka burime shtesë. Metodat që lidheshin më ngushtësisht me aktivitetet e ardhshme të Rrjetit të Mësuesve përfshinin vizita studimore, videokonferenca, krijimin e një portali për të shkëmbyer praktikën e mira të mësimdhënies dhe të të mësuarit, organizimin e tryezave të rrumbullakëta, seminareve dhe workshopeve online. Përdorimi i platformave në ueb dhe i rrjeteve u panë gjithashtu si mënyra të rëndësishme për të përmirësuar praktikën e arsimit gjithëpërfshirës.

4. Diskutimi dhe vijmësia

A ka ndonjë problem që modulet dhe programet janë kaq të shumëllojta?

Shumëllojshmëria e programeve vjen si rrjedhojë e përpjekjeve të shumta të shoqërisë civile për të plotësuar nevojat për trajnim që universitetet dhe ministrinë nuk janë ende në gjendje t’i plotësojnë tërësisht. Por, njohuritë e marra në kurse apo module për arsimin gjithëpërfshirës nuk përkthehen lehtësisht në praktikë. Shkollat nuk ndihmohen sa duhet në integrimin e programeve dhe qasjeve të shumëllojta dhe prandaj mund të mos dinë nga t’ia mbajnë kur përballen me grupe rekomandimesh të ndryshme që ata duhet t’i zbatojnë. Në shumë raste, mungojnë aktivitetet vijuese që lidhen me zbatimin e qëndrueshëm. Për të zhvilluar një profesion, njohuritë e përbashkëta, metodat dhe praktikën e përbashkëta janë më se të rëndësishme. Aktualisht, mungon bashkëpunimi sistematik midis institucioneve të trajnimit të mësuesve, shkollave dhe organeve përgjegjëse të qeverisë. Ka nevojë për rritjen e bashkëpunimit të ndërthurur midis universiteteve, ministrive, shkollave

dhe ofruesve të edukimit të mësuesve, për të ndihmuar në krijimin e një vizioni të përbashkët për edukimin e mësuesve për gjithëpërfshirjen.

Veçanërisht modulet e ofruara nga OJQ-të kanë tendencë të adresojnë grupe të ndryshme të synuara dhe jo vetëm mësuesit dhe profesionistët e tjerë, por edhe zyrtarë, prindër dhe anëtarë të tjerë të komunitetit. Mund të ketë nevojë për të diskutuar më në thellësi atë që mund të arrihet përmes këtyre aktiviteteve trajnuese, llojeve të nevojave për trajnim që kanë këto grupe, ose nëse strategji të tjera mund të jenë më efikase. Ka një konsensus në lidhje me idenë se realizimi i arsimit përfshirës kërkon ndryshime në nivele individuale, ndër-personale dhe sistematike. Aktualisht, projektet individuale – që shpesh ofrojnë edhe trajnim – bashkekzistojnë në terren me premisën se të gjithë kontribuojnë në një farë mënyre për zbatimin e praktikave më gjithëpërfshirëse në nivel klase, shkollë dhe komuniteti. Por, nuk është e qartë se si praktika të tilla të shumëllojshme mund të kontribuojnë në drejtim të një procesi zhvillimor pa pasur një vizion të qartë të asaj që duhet arritur bashkërisht.

A përkthehet trajnimi në praktikë?

Shumëllojshmëria e ofruesve, moduleve dhe programeve të trajnimit do të thotë gjithashtu shumëllojshmëri konceptesh, mjetesh dhe metodash. Parimet e përqafuara gjerësisht si “përfshirja”, “drejtësia sociale”, “qasja e bazuar te të drejtat” duhet që në një farë mënyre të përkthehen në aktivitete që mund të përdoren në klasa. Teoritë duhet të transformohen në njohuri shtesë pa qenë tepër përshkruese. Sot dihet pak për mënyrën se si bëhet kjo dhe nëse strategjitë e përdorura nga ofruesit ose – kur mungojnë strategji të tilla – nga mësuesit vetë janë apo jo efikase. Sikurse u vu në dukje nga pjesëmarrësit në workshope, transformimi i njohurive nga ajo çka është mësuar në atë që bëhet në klasa shpesh nuk është i kënaqshëm. Ka nevojë për një vështrim më të kujdesshëm të koncepteve që duhen mësuar dhe të kontekstit në të cilin duhen dhënë, dhe se si kjo njohuri do të ndihmojë për të zhvilluar praktika mësimi që të bëhen më gjithëpërfshirëse. Programet e “Trajnimit të trajnerëve” janë popullore në rajon për zbatimin e një arsimit gjithëpërfshirës. Por, studimi dhe përvoja tregojnë se kur njohuritë dhe metodat shkojnë poshtë deri në nivelin e bazës, shumë nga idetë fillestare humbasin rrugës.

A janë mësuesit të qartë për atë që pritet prej tyre?

Nga perspektiva e mësuesve të veçantë, e karrierës dhe e zhvillimit profesional të tyre, ka nevojë të sqarohet ajo që pritet prej tyre në secilën fazë dhe cilat aktivitete të të nxëniet apo aktivitete trajnuese do të kontribuojnë në arritjen e kompetencave të pritura prej tyre. Edukimi i mësuesve për përfshirje duhet kuptuar si një proces që zgjat gjatë gjithë jetës për të fuqizuar mësuesit si nxënës aktivë, si nxitës së zhvillimit të tyre profesional dhe atë të të tjerëve. Njohuritë dhe kompetencat që mësuesit fitojnë në programet fillestare, në punë apo në programet e këshillimit duhen integruar, me qëllim që të kenë një ndikim në praktikë. Përsëri, një qasje e tillë gjithëpërfshirëse duhet të varet nga bashkëpunimi midis institucioneve të trajnimit të mësuesve, shkollave dhe organeve qeveritare të përfshira në kualifikimin e mësuesve dhe akreditimin e moduleve të trajnimit.

A janë përpjekjet aktuale mjaftueshmërisht të mira?

Shpenzohet shumë energji dhe bëhen shumë përpjekje për të ndërtuar kapacitetet e mësuesve për arsimin gjithëpërfshirës, por përpjekjet e bëra nuk janë të koordinuara mirë. Mund të jetë e nevojshme një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj edukimit të mësuesve për gjithëpërfshirjen, me qëllim që të bashkohen aktivitetet aktuale, të rritet efikasiteti i tyre veç e veç dhe së bashku. Një qasje e bazuar më shumë te nevojat, ku shkollat të luajnë një rol aktiv në përcaktimin e nevojave të tyre për trajnim, mund të jetë me dobi, por vetëm nëse shkollave u jepen udhëzimet dhe mjetet e nevojshme për të qartësuar nevojat e tyre. Përpjekjet aktuale për të krijuar një kuadër kompetencash të mësuesve për arsimin gjithëpërfshirës mund të jenë një nga mjetet që mund të ndihmojë në identifikimin e kërkesave për

trajnim. Një rol më aktiv i shkollave mund të lehtësonte zbatimin në praktikë të trajnimit të marrë. Sikurse vunë në dukje pjesëmarrësit në workshop, edukimi i mësuesve duhet të jetë pjesë e një procesi më të gjerë të zhvillimit të shkollave ku aktivitete të tjera si bashkëpunimi me shkollat e tjera, projekte të shkollave dhe të mësuarit nga shokët mund të kontribuonin gjithashtu për një shkollë dhe klasë më gjithëpërfshirëse.

Çfarë mund të bëjë Rrjeti i Mësuesve?

Pjesëmarrësit e Rrjetit të Mësuesve kanë dalë me shumë ide për atë që mund të bëhet për të përmirësuar praktikën aktuale dhe mbase disa prej tyre mund të ndiqen në të ardhmen. Ata ishin në favor të planifikimit të projekteve me zbatim të gjithanshëm, që fusin instrumente apo metoda të reja, të cilat përfshijnë aktivitete trajnuese apo kërkimore, duke plotësuar nevojat dhe interesat e shumëllojta të partnerëve të ndryshëm dhe në të njëjtën kohë duke kontribuar për qëllimin e përgjithshëm. Një metodologji e tillë e integruar përputhet mirë edhe me qasjen e një shkolle të tërë, e cila nuk e konsideron arsimin gjithëpërfshirës si diçka të veçantë, por si të lidhur ngushtë me edukimin qytetar dhe edukimin për një zhvillim të qëndrueshëm. Pjesëmarrësit gjithashtu mbështetën praktikën e shkollave që paraqesin projektet e tyre në vend dhe jo t'u lihet ofruesve të përcaktojnë nevojat e tyre. Intervistat sugjeruan se Bosnja dhe Hercegovina ka më përvojë në këtë punë, krahasuar me përfituesit e tjerë. Projekti i Përbashkët po krijon një mjedis të ngjashëm dhe Rrjeti i Mësuesve mund të ndihmojë në rritjen e kapacitetit të shkollave për të zhvilluar programe që bazohen në nevojat e tyre specifike për trajnim dhe zhvillim.

Disa organizata duken se kanë rrjete që janë të përhapura në pjesën më të madhe ose në të gjitha zonat e rajonit, për shembull, Rrejt i Shoqërisë së Hapur, Save the Children dhe UNICEF. Këto organizata mund të jenë partnerë strategjikë jo vetëm për punën e ardhshme të Rrjetit të Mësuesve dhe Projektit të Përgjithshëm si një i tërë, por edhe për ministritë përkatëse. Partneritetet publike-private mund të përdoren për të zhvilluar praktika gjithëpërfshirëse në komunitete. Partneritete të rastësishme të bazuara në projekte publike-private midis donatorëve, shkollave, universiteteve, dhe ministrive mund të kthehen në partneritete strategjike, duke angazhuar të gjithë partnerët ndaj një udhërrëfyesi të përbashkët dhe ndërtimin e planeve të tyre të veprimit bazuar në një qëllim të përbashkët afatgjatë, duke marrë parasysh nevojat më të rëndësishme që duhen adresuar. Rrjeti i Mësuesve mund të jetë në gjendje gjithashtu të krijojë disa strategji për mënyrat e mundshme për të ecur përpara; kjo gjë do të ndihmonte për t'i çuar përpara iniciativat e tyre kur aktivitetet e Projektit të Përbashkët të përfundojnë në nëntor të vitit 2015.

Ne cilat aktivitete mund të angazhohen tre Rrjetet së bashku?

Anëtarët e Rrjetit të Mësuesve kanë zhvilluar ndërkohë një vizion të një mësuesi gjithëpërfshirës dhe të metodave që mbështetin rritjen e kapaciteteve dhe zhvillimin e kompetencave. Mund të ketë disa mundësi në të ardhmen për ta afruar edhe më shumë punën e tre rrjeteve. Rrejt i Shkollave kërkon të zhvillojë praktika gjithëpërfshirëse në shkolla dhe komunitete; Rrjeti i Mësuesve, zhvillimin profesional të mësuesve, ndërsa Rrjeti i Politikave të fokusohet te politikat që krijojnë kontekstin social të shkollave dhe mësuesve. Përdorimi i përbashkët i modelit të aktiviteteve dhe paraqitja e aktiviteteve të tre rrjeteve mund të ndihmojë për t'i bashkuar përpjekjet e tyre të veçanta. Së bashku, ato mund të bëjnë një përshkrim të pasur të aktiviteteve të përgjithshme që kërkohen për të siguruar një arsim përfshirës dhe bazuar në të, kontributet e duhura për mënyrat e mundshme për të ecur përpara për të gjithë pjesëmarrësit në projekt.

Në rast se kjo mundësi do të përdorej në shkallën maksimale, do të ndihmonte gjithashtu për të eksploruar mënyrat për të mbushur boshllëkun midis politikave, edukimit të mësuesve, kërkimit dhe praktikës. Rrjetet individuale mund të angazhohen në aktivitete që mund të kontribuojnë në një proces të përgjithshëm të zhvillimit të arsimit përfshirës. Me qëllim që të ndodhë kjo gjë, duhet menduar edhe më shumë për gjithë sistemin e përgjithshëm të aktiviteteve që Projekti i Përbashkët kërkon të zhvillojë. Ushtrime të ndërtimit të

vizionit, të diskutimeve rreth mjeteve mund të zhvillohen në rrjetet e tjera, si edhe për të pasuruar vizionin e përcaktuar në fillim të projektit: Një shkollë gjithëpërfshirëse është ajo shkollë ku çdo fëmijë është i mirëpritur, ku çdo prind është i përfshirë dhe çdo mësues është i çmuar.

5. Referenca

- Këshilli i Evropës (2009). Diversiteti dhe përfshirja: sfidat për edukimin e mësuesve. Kompetencat kyç për diversitet. Strasburg: Këshilli i Evropës.
- Këshilli i Evropës (2010). Politikat dhe praktikat për mësimin e diversitetit socio-kulturor. Diversiteti dhe përfshirja: sfidat për edukimin e mësuesve. Strasburg: Botim i Këshillit të Evropës.
- Y. Engeström, (1987). Të mësuarit përmes zgjerimit: Një qasje bazuar në aktivitete-teori ndaj studimeve zhvillimore. Helsinki: Orienta-Konsultit.
- Y.Engeström, (2001). Të mësuarit e zgjeruar në punë: Drejt një konceptimi bazuar në aktivitete-teori. *Journal of Education and Work*, 14(1), 133-156.
- Y. Engeström, Y. (2008). Nga ekipet te nyjat. Studime teorike për aktivitetet e bashkëpunimit dhe të mësuarit në punë. Kembrixh: Cambridge University Press.
- Agjencia Evropiane për Zhvillim në Arsimin për Nevoja të Veçanta (2012). Edukimi i mësuesve për përfshirje. Profili i mësuesve. Odense: Agjencia Evropiane për Zhvillim në Arsimin për Nevoja të Veçanta.
- Agjencia Evropiane për Zhvillim në Arsimin për Nevoja të Veçanta (2013). Organizimi i ofrimit të mbështetjes së arsimit përfshirës – Literature Review, Odense, Danimakrë: Agjencia Evropiane për Zhvillim në Arsimin për Nevoja të Veçanta.
- Komisioni Evropian (2013a). Arsimi dhe trajnimi në Ballkanin Perëndimor. Raport mbi sintezën përfundimtare. Luksemburg: Bashkimi Evropian.
- Komisioni Evropian (2013b). Mbështetja e zhvillimit të kompetencës së mësuesve për rezultate më të mira në mësim. Bruksel: Komisioni Evropian.
- K. Hakkarainen, T. Palonen, S. Paavola, E. Lehtinen, E. (2004). Komunitetet e ekspertizës së rrjetëzuar. Perspektiva profesionale dhe edukative. Emerald.
- N. Pantić, A. Closs, & V. Ivošević, (2011). Mësuesit e të ardhmes: Zhvillimi i mësuesve për arsimin përfshirës në Ballkanin Perëndimor, Torino: Fondacioni Evropian i Trajnimit.